



# Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

## Odeljenje za Zaštitu i Spašavanje

### Department of Protection and Rescue



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA E KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. i prot. 2324 Më 17.06 2020  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

## MBROJTJA NGA ZJARRI

Shpëtimi i jetës dhe i pasurisë

Qytetarë të nderuar

Stina e verës sjell temperatura të larta të ajrit, të cilat e shtojnë rrezikun për shtaqjen e zjarreve në zonat malore, fushore si dhe në vendbanime. Duke pasur parasysh pasojat e katastrofave që mund të vijnë nga shpërthimet e zjarreve, përfshirë edhe jetën e njerëzve.

## APELOJMË

Të jemi të kujdesshëm dhe vigjilent për shmangiljen e gjithë shkaktarëve të mundshëm të zjarrit. Zjarri mund të shkaktohet me një fije shkrepëse, por nuk mund të shuhet me ekipe të tëra të zjarrfikësve, përderisa pasojat mund të jenë të pa parashikueshme. Vëzhgimi i ajërimit dhe alarmimit në kohë të shtaqes së zjarrit do të mundësojë intervenimin e shpejtë dhe efikas të Shërbimeve Zjarrfikëse dhe ekipeve të shpëtimit në lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit. Si duhet të veprimi në rast zjarri:

• Qëndro i qetë dhe mos bë panik!

• Thirr numrin 112 dhe lajmëro zjarrin (prezantohu, trego vendin e saktë, adresën dhe ndërlidhe atë me ndonjë objekt të vendësisë, mbaje linjën telefonike të lirë). Nëse zjarri është në fazën fillestare provo të eshuash duke përdorur batanije, shtroje, ujë, rërë apo aparatën për fikje të zjarrit. Zjarret e shkaktuara nga rrymë nuk guxojnë të shuhen me ujë. Këto zjarre shuhen me anë të aparateve për fikje të zjarrit të mbushura me CO2.

• Shkyqje ndërprerësin kryesorë nëse mund ti qasesh!

• Nëse zjarri përfshin rrobat e trupit atëherë mbulohu me një batanije ose shtrihuni në dysheme dhe rrokullisu.

• Në rast të shtaqes së tymit qëndro në shtëpi dhe përdorë gjërat të lagura. Mbylli të gjitha të çarat, vrimat nga mund të hyjë tymi në dhomë.

• Qëndro sa më poshtë që mundesh, nëse është e nevojshme shtrihu në dysheme që të ikësh tymit

## Informimin mund ta bëni në:

- Kur të arrijnë zjarrfikësit sinjalizoi për vendndodhjen tënde.
- Gjatë gjithë kohës qëndro në linjë telefonike me numrin emergjent 112.

• Qendren e Alarmimit nëpërmjet numrit të integruar emergjent – 112. Numrin emergjent - 112 mund ta thirrni dhe ta merrni pa prefix, nga çdo vend apo pozitë (tunele, puse, podrumë, humnera, etj) në Republikën e Kosovës.

• Shërbimin për Zjarrfikës dhe Shpëtim mund ta merrni në numrin fiks 93, ndërsa me telefon celular prej VALËS 193 dhe prej telefonit celular të IPKO-s 933.

• Policinë e Kosovës mund ta merrni në numrin e telefonit fiks 92 dhe 192 në telefonin celular.

• Ndihmën e shpejt mjekësore mund ta merrni në numrin e telefonit fiks 94, e celulare prej VALËS 194 dhe IPKO-s 944.

Të gjitha thirrjet telefonike emergjente në numrin fiks dhe celulare janë falas.

Ligji për Mbrojtje nga Zjarri nr. 04/L-027 i obligon të gjithë qytetarët që të ndërmarrin të gjitha masat për mbrojtje nga Zjarri.

